

**FJALIMI I ZAHIR TANINIT, PËRFAQËSUES SPECIAL I
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-ut
DEBATI NË KËSHILLIN E SIGURIMIT PËR UNMIK-un**

Nju Jork

25 gusht 2016

Z. President, anëtarë të Këshillit,

Kam kënaqësinë të informoj Këshillin mbi zhvillimet aktuale kryesore në Kosovë që nga raporti i fundit i Sekretarit të Përgjithshëm, dhe të jap disa konstatime.

Situata në Kosovë gjatë tre muajve të fundit ka qenë më stabile se sa që ishte gjatë periudhave të mëparshme të raportimit. Megjithatë, kërcënimi i sigurisë dhe tensionet politike ende janë të pranishme. Pas një periudhe të qetësisë relative dhe pas disa muajve të bllokimeve të pakontrolluara në Kuvendin e Kosovës, një çështje e vetme u shty përpara me polemika të reja: ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin territorial të Kosovës me Republikën e Malit të Zi. Paskan argumentet dhe akuzat politike, shpesh duke shkuar larg nga faktet bazike. Kjo ndjenjë publike irituese e pengoi funksionimin e Kuvendit dhe e vonoi punën në çështje më urgjente. Edhe pse marrëveshja është arritur me përkrahje të argumentuar ndërkombëtare, diskutimi për ratifikimin e saj nga Kuvendi u shty.

Nuk ka dyshim që përpjekjet për ndërtimin e konsensusit është dashur të bëhen shumë më herët, shumë më përpara se çështja të bëhet mollë shërri për debatet e ashpra dhe me ngjyrimë partiake.

Pavarësisht nga kjo, liderët politikë kanë ndërmarrë përpjekje të reja për të dhënë përgjigje në ndonjë pyetje shtesë.

Në ndërkohë, partitë politike vazhdojnë të punojnë në prapaskenë në përpjekje për të gjeneruar, shfrytëzuar dhe, nëse është e mundur, për të prolonguar momentet e tilla të 'krizës'. Çfarëdo suksesi që ata përfundimisht mund të arrijnë në fuqizimin e një poli alternativ të ndikimit, opozita duket se është më e vetëdijshme se përdorimi i dhunës është kontraproduktiv për këtë qëllim. Përveç kësaj, aktet e dhunës politike, duke përfshirë tri incidentet gjatë muajit gusht ku u përdorën lëndë eksplozive, që në shënjestër kishin Kuvendin, shtëpinë e zyrtarit të Kosovës dhe selinë e një transmetuesi publik, janë absolutisht të papranueshme. Ata janë një problem që duhet të vazhdojë të menaxhohet në mënyrë të përgjegjshme nga autoritetet.

Nga bisedat e mia të fundit me liderët më të lartë në Kosovë, kam përshtypjen se këta liderë e kuptojnë nevojën për të vendosur realizmin dhe zbatueshmërinë më lart në agjendën e tyre politike. Shumë prej tyre sytë i kanë drejtuar në shfaqjen e tendencave më të gjera, dhe në gjasat që këto tendenca ofrojnë për shfrytëzimin e mundësive, si dhe në heqjen e pengesave të vjetra në mënyrë që të arrihet përparim më i shpejtë.

Z. President,

Unë e kam fituar përshtypjen e njëjtë për lidërsipin lokal gjatë vizitave të mia në komuna dhe komunitete në mbarë Kosovën. Në Gjakovë, kryetarja e komunës tha se *'pushteti vjen me përgjegjësi, jo vetëm me privilegje'*. Në veri të Mitrovicës, shqetësimet kryesore ishin qasja në punësim, në shërbime publike të sigurta dhe besimi në institucionet qeverisëse. Në Obiliq, ndikimi i termocentraleve të vjetruara energjetike në afërsi të qytetit, për të cilat komuna është pyetur pak apo fare nuk është pyetur, rrezikon shëndetin dhe sigurinë publike, dhe zvogëlon kohezionin social dhe rritjen ekonomike lokale. Në Vushtrri, unë kuptova se komunitetet e ndryshme janë në gjendje të punojnë së bashku për një të ardhme të përbashkët, dhe se qeverisja gjithëpërfshirëse është njëri prej elementeve kyçe që nevojitet për këtë punë. Unë e dëgjova dëshirën për marrëdhënie të përmirësuara dhe për më shumë besim në mesin e komuniteteve etnike.

Pas të gjitha këtyre, është e qartë se çështjet ekonomike, arsimore dhe të kujdesit shëndetësor, si dhe sundimi i ligjit dhe luftimi i korrupsionit, janë shqetësimet dominuese të njerëzve në nivel lokal, më shumë se sa politikat ndëretnike. Kohët e fundit një i ri në rajonin e Prizrenit mu afrua për të më thënë se ‘korrupsioni është problemi më i madh për gjeneratën time dhe për të gjithë popullin në Kosovë’, një shqetësim që unë e kam dëgjuar në shumë raste.

Në mbarë ish-Jugosllavinë, gjenerata e parë pas konfliktit tani ka arritur moshën për votim, dhe shumë prej tyre tash janë duke u diplomuar në arsimin e lartë. Shumë të rinj kanë ditur pak për ‘jetën publike’ përveç retorikës përçarëse pas konfliktit. Nëse do të arriheshin stabiliteti dhe prosperiteti, gjenerata e paskonfliktit ka nevojë për orientime më të qarta dhe për mundësi më të mira, si banorë të Evropës moderne dhe si qytetarë të botës. Mungesa e zanateve dhe profesioneve premtuese, korrupsioni publik, ekstremet e pabarazisë ekonomike - të gjitha i ndajnë komunitetet shumë më tepër se sa nacionalizmat etnikë apo religjiozë. Kështu që, një nxitje për pajtim paraqitet nga popullata, por sipas mendimit tim po ashtu ka nevojë të fuqizohet nga lart, pra nga liderët. Nga disa liderë, unë tanimë e dëgjoj këtë në mënyrë të qartë, por e kam dëgjuar edhe nga segmente dhe sektorë të tjerë të shoqërisë, ku individët e kuptojnë rëndësinë e lënies së të kaluarës pas nëse bëhet lëvizje kuptimplote përpara.

Duke u kthyer nga Beogradi dje, gjatë bisedimeve mua gjithashtu më bënë përshtypje liderët e lartë për rëndësinë që i dhanë bashkëpunimit rajonal, dhe të kuptuarit më të mirë të pozicioneve të palëve të tjera, gjatë punës në tejkalimin e pengesave për besim dhe përparim. Sikurse edhe në Prishtinë, ata gjithashtu theksuan specifikisht nevojën që dialogu i drejtuar nga BE-ja të jetë i suksesshëm. Kryeministri Vuçiq, në veçanti, më tha se shumë kohë po humbej, dhe ajo çka nevojitet është përkushtim shumë më i rëndësishëm dhe më i madh, si dhe punë e pandërprerë për dialogun – jo vetëm nga liderët dhe negociatorët, por edhe nga Bashkimi Evropian, si dhe nga të gjithë ne në bashkësinë ndërkombëtare.

Z. President,

Dialogu i nivelit të lartë i drejtuar nga BE-ja mbetet gurthemel në rrugën drejt pajtimit. Perspektiva evropiane është ajo që vazhdon të jetë udhëheqësi kryesor i reformimit, veçanërisht në fushat vitale të qeverisjes, në sundimin e ligjit dhe në të drejtat e njeriut. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, vazhdoi arritja e përparimit në disa fusha, duke përfshirë edhe fillimin e revitalizimit të urës kryesore në Mitrovicë, si dhe zvogëlimin e dallimeve në çështjen e telekomunikimeve. Sa u përket marrëveshjeve të tjera, në veçanti të asaj për Bashkësinë/Asociacionin e komunave me shumicë serbe, qartazi është e nevojshme një punë më e përqendruar.

Është e natyrshme që vonesat në implementim mund të shpien në gjykimin e vet procesit nga vëzhguesit dhe pjesëmarrësit e ngjashëm. Lidershpi nga të dyja anët është të paktën aq i rëndësishëm sa edhe pragmatizmi dhe përkushtimi – jo vetëm për ta rforcuar, por mundësisht edhe për ta thelluar këtë proces që të shkojë përpara.

Z. President,

Pak pjesëtarë në mesin e komuniteteve joshumicë të zhvendosur nga konflikti janë kthyer në shtëpitë e tyre, dhe nga ata të kthyer, shumica nuk kanë qëndruar aty. Rreth 16,000 persona janë ende të zhvendosur brenda Kosovës, me shumë më tepër jashtë vendit. Me kalimin e kohës, shumica deri tani kanë ndërtuar jetë të reja në vendet ku ata janë zhvendosur. Sidoqoftë, kthimi vullnetar, i sigurt dhe i dinjitetshëm i personave të zhvendosur është një e drejtë themelore, dhe kjo çështje duhet, besoj unë, të kthehet përsëri në fokus nga të gjithë, duke përfshirë edhe komunitetin ndërkombëtar. Për të arritur kthimin, nevojitet angazhim konstruktiv me të kthyerit dhe me komunitetet që i pranojnë të kthyerit, që duhet të harmonizohet me përkushtimin politik, por çka është edhe më e rëndësishme, me zotimin e resurseve. Sipas UNHCR-së, tani për tani rreth 9,400 persona të zhvendosur janë regjistruar për t'u kthyer. Që kjo të ndodhë, duhet të demonstrohen zotime të qarta dhe realiste në ndarjen e resurseve të nevojshme dhe të sigurohen kushtet e duhura.

Kosova ka një trashëgimi të pasur dhe të shumëllojshme kulturore: duke përfshirë diversitetin religjioz, gjuhësor, artistik dhe shoqëror. Sistemi i Kosovës ka legjislacion gjithëpërfshirës që mbron liritë e përdorimit të gjuhës, të asociimit dhe besimit në fe. Implementimi dhe përmbartimi i plotë i këtyre kornizave të fuqishme legjislative mbetet qëllimi esencial.

Gjatë tre muajve të fundit, nuk ka pasur trazira ndëretnike të përmasave të mëdha, as sulme të rënda ndaj objekteve kulturore. Sidoqoftë, grupet e rrezikuara, në veçanti në mesin e komuniteteve joshumicë, janë të nënshtruar ndaj kërcënimeve të niveleve më të larta. Statistikat në këtë fushë duhet gjithmonë të trajtohen me kujdes të madh, por ato që UNMIK-u i ka në dispozicion tregojnë se mesatarisht ka rreth njëzet e pesë krime ‘potencialisht të motivuara etnikisht’ të regjistruara në Kosovë çdo muaj. Të gjitha komunitetet janë të prekura, dhe shpesh konstatohet se motivet primare të krimeve nuk kanë qenë politike. Por duhet theksuar se viktimat e kërcënimeve gjithmonë kanë një perspektivë ndryshe nga ata të cilët nuk i kanë përjetuar ato. Kësaj të vërtete esenciale i nevojitet më shumë ndjeshmëri nga autoritetet nga të gjitha anët, po ashtu edhe nga ne.

Lidhur me pajtimin, dua të përgëzoj iniciativat e guximshme të ndërmarra nga presidenti Thaçi. Më 21 korrik, ai vizitoi dhe nderoi tek pllaka përkujtimore, duke përkujtuar katërbëdhjetë civilë serbë të Kosovës nga Staro Gradsko, të cilët ishin vrarë në atë fshat menjëherë pas përfundimit të armiqësive. Pas disa ditësh ai vizitoi një përmendore tjetër për një krim të pazgjidhur kundër serbëve të Kosovës, në fshatin Gorazhdevc, ku në vitin 2003 ishin vrarë disa të rinj që ishin duke u larë lumë.

Këto vizita na kujtojnë të gjithëve gjithashtu faktin se të gjithë liderët ndajnë përgjegjësinë e madhe për të bërë më shumë që të ndihmojnë zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur nga koha e konfliktit. Shtatëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të konfliktit, fati i mbi 1,600 personave mbetet i pazgjidhur. Të gjitha komunitetet janë të prekura nga humbja. Çështja e personave të zhdukur nuk duhet

lejuar të hiqet nga agjenda politike. Personat e zhdukur do të gjinden dhe fatet e tyre do të zbardhen vetëm nëse ka përkushtim të sinqertë dhe të vazhdueshëm nga të gjithë, duke përfshirë Misionin tonë.

Z. President,

Fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm është një sfidë globale që po evoluon shpejt. Në Kosovë është e njohur prania e elementeve dhe e organizuesve radikalë islamikë. Autoritetet vendore kanë ndërmarrë masa të shumta të fuqishme për të zvogëluar kërcënimin, por prania e elementeve të cilët kanë marrë pjesë në luftërat e huaja të fundit na jep të gjithë neve arsye për të qenë vigjilent dhe të vetëdijshëm. Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë një qasje të fuqishme për zbatimin e ligjit ndaj atyre që përkrahin dhunën dhe që i ndihmojnë luftëtarët vullnetarë. Ashtu siç ata e kanë pranuar, kjo mund të realizohet vetëm atëherë kur kjo të bëhet bashkërisht me një qasje zhvillimore, që në mënyrë të efektshme do të vinte në shënjestër nxitësit socio-ekonomikë të ekstremizmit në Kosovë. Një rol të rëndësishëm duhet të luaj edhe komuniteti ndërkombëtar, përmes ndihmës së të bashkërenduar mirë, duke përfshirë ndihmën edhe të Kombeve të Bashkuara.

Z. President,

Ditëve të fundit, ne kemi fuqizuar shumë angazhimin tonë konstruktiv me liderët e Kosovës, që u reflektua, në mes të tjerash, në takimet e rëndësishme me kryetarin Thaçi, me kryeministrin Mustafa dhe me ministrin e Punëve të Jashtme, Hoxhaj. Angazhimi im konstruktiv me liderët e Beogradit, duke përfshirë edhe diskutimet e mia këtë javë me presidentin Nikoliq, me kryeministrin Vuçiq dhe me zëvendëskryeministrin e parë dhe me ministrin e Punëve të Jashtme, Daçiq, janë esenciale për rolin tonë të balancuar dhe objektiv, brenda kornizës së bashkëveprimit rajonal, dhe në drejtim të realizimit të plotë të mandatit tonë.

Në fund, dua të theksoj se gjatë muajve të fundit, ne tërësisht kemi rishikuar aktivitetet e Misionit, dhe kemi krijuar një vizion të fokusuar jo vetëm për riformësimin dhe përmirësimin e punës tonë, por edhe për krijimin e një atmosfere me të gjitha palët me interes që Misionit do t'i mundësonte të angazhohet në mënyrë më efikase dhe efektive. Kjo përfshin angazhim në çështjet ekzistuese dhe në ato që do të paraqiten, siç është problemi global i ekstremizmit të dhunshëm dhe krijimi i kornizave të zbatueshme për pajtim. Thënë shkurt, ne do të implementojmë objektivat që ju na i keni besuar në mënyrë më të përditësuar.

Ju faleminderit për përkrahjen e vazhdueshme që i jepni UNMIK-ut.